

## 4.1 KRIJIMI I OBJEKTIT

### Procedura

1. Në pjesën e dritares me modulet dhe klasat përzgjidhni klasën.
2. Përzgjidhni metodën **Klasa / Objekti i ri**.  
Hapet redaktuesi i objektit.



#### Shembull:

Listën e re të çmimeve e krijoni duke përzgjedhur klasën **Lista e çmimeve** dhe më pas metodën **Klasa / Objekti i ri**.



#### Këshillë:

Objektin mund ta krijoni edhe duke shtypur tastet <Ctrl> + <N>, pasi të keni përzgjedhur klasën.

### Mundësitë...

Objektin mund ta krijoni edhe përmes:

- metodës, që mundëson zhvillimin e procesit të punës



#### Shembull:

Në modulën COBISS3/Pasurimi krijoni objektin e ri në klasën **Fletëdërgesa** duke gjetur dhe përzgjedhur objektin e caktuar në klasën **Porosia**. Më pas përzgjidhni metodën **Objekti / Regjistro fletëdërgesën**.

- butonit për krijimin e objektit të përfshirë në redaktuesin e objektit të përzgjedhur (shih kap. 4.2.3.1 dhe kap. 4.2.3.2)



#### Shembull:

Në modulën COBISS3/Pasurimi, në klasën **Njësia e porosisë** objekti i ri krijohet duke klikuar butonin **Objekti i ri** në redaktuesin **Porosia**.

### Hapat në vazhdim...

Vendosen vetitë e objektit dhe ky i fundit ruhet.